



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

Prishtinë, 14 shtator 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiut të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë



HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 14 shtator 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Villa Gërmia” në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Fillimi i vitit të ri shkollor 2011-2012, vështirësitë dhe sfidat
- Plotësimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale- kontratat e punës të mësimdhënësve
- Prezantim i projektit për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor në Kosovë nga GIZ

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Arsimit nga Komunitet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Po ashtu prezent në takim ishte edhe z. Xhavit Dakaj - Sekretar i përgjithshëm në MASHT si dhe përfaqësuesit për sektorin e arsimit nga GIZ. Takimi u kryesua nga kryesuesi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë z. Azem Guri.

PËRMBLEDHJE

Në hyrje të takimit kryesuesi prezantoi dhe uroj mirëseardhjen Sekretarit të MASHT-it si dhe përfaqësuesve nga GIZ për pjesëmarrje dhe prezantim të projektit në zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor në Kosovë.

Në vazhdim të takimit z. Xhavit Dakaj Sekretar i përgjithshëm në MASHT uroj punën e kolegjiut të arsimit dhe shprehu mirënjohjen se kolegjiut ka ndihmuar me punën e përbashkët në përmirësimin e sistemit arsimor si dhe dha përkrahjen dhe ndihmën e Ministrisë për një bashkëpunim sa më të suksesshëm.

z. Sazan Guri drejtor ekzekutiv në AKK, potencoi se kolegjiut për arsim ka një bashkëpunim të ngushtë me MASHT-in dhe me donatorë të ndryshëm në fushën e arsimit nga e gjithë kjo me rëndësi është që rekomandimet e dala nga ky kolegjiut të merren për bazë nga Ministria si pjesë përbërëse e vendimmarrjes së bashku me strukturat komunale.

z. Guri njoftoi të pranishmit rreth pilot projektit së bashku me Bankën Botërore në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe aktiviteteve në shkollë, ku projekti përfshin disa shkolla fillore dhe të mesme në disa komuna të Kosovës. Po ashtu kryesuesi informoi se është përgatitur një rregullore për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të përpiluar nga Drejtoria Komunale e Arsimit e Kaçanikut. Të gjithë u pajtuan që kjo rregullore të shpërndahet nga AKK-ja tek të gjitha komunat ku mund të shërbejë si praktikë e mirë për të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Bashkangjitur në **aneksin 1** keni projekt rregulloren për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme.

Sa i përket temës së fillimit të vitit të ri shkollor 2011-2012, vështirësitë dhe sfidat e komunave në sektorin e arsimit, u paraqitën shumë shqetësime dhe vërejtje të drejtorëve komunal arsimit sa i përket mungesës së inventarit shkollor, mos koordinimi për pranimin e mësimit në shkolla, mungesa e infrastrukturës ligjore, problemet rreth certifikatave dhe nostrifikimit të diplomave, sqarimi rreth pranimit të mësimit me diploma të ndryshme si ata me normale, ose të larta dhe bachelor tre apo katër vjeçar si dhe definimi i qartë për pozitat e tyre nëse kanë përparësi personat me fakultet të edukimit!

Njëra ndër kërkesat për sqarim ishte edhe ajo e kontratave të mësimit të kualifikuar dhe të pakualifikuar, si duhet të vepron në raste të tilla a duhet të ketë një model unik për kontrata?

Çështjet tjera që u evidentuan ishin edhe ato sa i përket pedagogëve në shkolla, çështja e kujdestarisë, e lehonisë, rikualifikimit të mësimit, pensionimit të parakohshëm, kërkesës për një kod të etikës së personelit arsimit në shkolla me një u. administrativ, zgjedhja e drejtorëve në shkolla dhe kërkesa për sigurimin e vendit të punës, funksionimi i komisioneve disiplinore për mësimit duke marrë parasysh se këto komisione refuzojnë të shqyrtojnë këto raste me arsyetimin se personeli arsimit nuk është staf civil, gjithashtu problemet me ekskursionet shkollore se kur duhet të ndërmerren ato, në fillim apo në fund të vitit shkollor, po ashtu një çështje më shumë rëndësi është edhe ajo e harmonizimit të normativit dhe U. Administrative.

Në përgjigjen e tij Sekretari i MASHT-it u mundua të jap sqarim kërkesave të shumta sa i përket çështjeve të ndryshme të ngritura nga drejtorët komunal të arsimit.

Në përgjigjen e tij theksoi ka një numër të madh të u. administrative me një numër të përafërt rreth 230, dhe prej tyre 160 janë të zbatueshme. Meqë ende ka persona të cilët thirren në këto u. administrative, Ministria po përpilon një liste me ato u. a të cilat nuk janë më në zbatim.

Sa i përket inventarit MASHT-i bën çka është e mundur të plotësojë kërkesat e shkollave për inventarin e ri, por duhet të ketë një mirëkuptim duke marrë parasysh buxhetin e Kosovës.

Në çështjen e diplomave sekretari informoj se drejtoritë komunale kanë njëjtë të drejtën ekskluzive në verifikimin e diplomave të mësimit dhe përcaktimin e një kodi etik të brendshëm në shkolla për mënyrën e veshjes dhe sjelljes së tyre në shkolla.

Sekretari në fjalën e tij theksoj se është i vetëdijshëm për çështjen e pensionimit të parakohshëm por edhe përkundër vullnetit të mirë kjo është mundësia buxhetore që ka qeveria e Kosovës.

Sa i përket komisionit disiplinor dhe funksionimit të tij duhet të ketë konsultime me zyrtarët ligjor komunal për interpretim të drejtë rreth funksionimit të tyre.

Në çështjen e ekskursioneve MASHT ka lëshuar urdhëresat administrative në mënyrë të qartë sa i përket kësaj çështje dhe drejtorët komunal duhet të respektojnë në mënyrë të përpiktë ato.

Me këtë rast sekretari informoj të pranishmit se në raportin e KE-së ka një vlerësim negativ sa i përket përzgjedhjes së personelit adekuat arsimor në shkolla si mësimdhënësit dhe menaxherë. Kjo është edhe një kritikë serioze nga Komisionit Evropian sa i përket drejtorive të arsimit komunal duke marrë parasysh se janë direkt përgjegjës në përzgjedhjen e këtij personeli.

Sekretari shprehu angazhimin e tij që në të ardhmen e afërt të organizohet një takim së bashku me kryesinë e kolegjiut dhe zyrtarët ligjorë të MASHT-it ku do të diskutoheshin më konkretisht shqetësimet e drejtorëve të DAK-ës për sqarime më të hollësishme të problemeve në fushën e arsimit.

Në pjesën e dytë një delegacion nga GIZ bëri prezantimin e projektit për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor në Kosovë. Në prezantim u sqarua roli i GIZ –it në partneritet me Drejtoritë e arsimit komunal, qëllimin primar dhe komponentët e programit, mënyrat e veprimit dhe qasjen në nivele të ndryshme. Më gjerësisht mund të shihni në **aneksin 2** programin e përgjithshëm të GIZ-it për zhvillimin e kapaciteteve arsimore në shkolla.

REKOMANDIMET:

- AKK të organizoj takimin e Kryesisë dhe Sekretarit të MASHT-it për të diskutuar dhe rishikimin e çështjeve të cilat u evidentuan në kolegjiut.
- Të jepen propozimet për ndryshime të udhëzimeve administrative
- Takimi i ardhshëm të ketë si temë të veçantë për diskutim Testin e Maturës
- Të shpërndahet nga AKK-ja projekt rregullorja për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme i përgatitur nga DKA – Kaçanik.